

Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Ulqinit

Plan veprimi për të rinj



Ulqin – Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” dhe Komuna e Ulqinit” nënshkruan javën e kaluar Marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila parasheh hartimin e Planit Lokal të Veprimit për të rinj.

Në takim në të cilin, përpos kryetarit të Komunës së Ulqinit, Fatmir Gjeka, morën pjesë edhe nënkryetarët e Komunës, Ardijan Mavriqi dhe Safet Beci, sekretari i Sekretariatit për Veprimtari Shoqërore, Ahmet Alosi, si dhe përfaqësuesit e Horizontit të Ri, u shkëmbyen informacione për nevojën, rëndësinë si dhe mënyrën e hartimit dhe aprovimit të Planit të Veprimit për të rinj. Marrëveshja e nënshkruar përcak-

ton bartësit e aktiviteteve gjatë procesit të hartimit të Planit të Veprimit, detyrat e tyre si dhe afatet e realizimit.

Sipas kësaj marrëveshjeje, Horizonti i Ri do të organizojë trajnimin dhe motivimin e të rinjve për pjesëmarrje në procesin e hartimit të këtij plani, do të realizojë hulumtimin e nevojave të të rinjve në terren, do të organizojë aktivitete publike e promovuese në komunitet si dhe do të koordinojë grupin ndërsektorial për shkrimin e Planit të Veprimit për të rinj.

Nga ana tjetër, Komuna e Ulqinit gjithë këtij procesi do t’i japë mbështetje institucionale dhe logjistike.

Hartimi i Planit të Veprimit për të rinj realizohet në kuadër të projektit të Horizontit të Ri me titull “Politika për të rinj në Ulqin”, të cilin e mbështet Fondi për Qytetari Vepruese, i financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Delegacionit të BE-së në Mal të Zi.

Afati i realizimit të këtij projekti është deri në fund të muajit dhjetor të këtij viti. **(Kohapress)**